



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0337
Data e Vendimit: 06.06.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 dhe nenit 64 të Rregullores Nr.002/2022 për Prokurim Publik pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik N.T.SH. "BEDI COM", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru per ngrohje te objektev te shkollav ne QKMF - AMF dhe njesive tjera vartese te A.K" me numër të prokurimit 634-22-8230-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Klinës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 06/06/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e N.T.SH."BEDI COM" me (Nr. të protokollit 2023/0337) e datës 05/06/2023, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru per ngrohje te objektev te shkollav ne QKMF - AMF dhe njesive tjera vartese te A.K", me numër të prokurimit 634-22-8230-1-1-1, inicuar nga Kuvendi Komunal i Klinës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK), kurse mbetet ne fuqi vendimi i AK i datës 15.05.2023 për anulim të aktivitetit.

Lejohet kthimi i sigurimit në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP, në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, kurse OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Kuvendi Komunal i Klinës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK) me 16.05.2023 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka anuluar procedurën e

prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru per ngrohje te objektev te shkollav ne QKMF - AMF dhe njesive tjera vartese te A.K” me numër të prokurimit 634-22-8230-1-1-1.

Me 20.05.2023 Operatori ekonomik (OE) N.T.SH."BEDI COM" kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK. Kurse me 23.05.2023 AK kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE si të pa bazuar.

Kundër vendimit të cituar si më sipër, OE i pakënaqur ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues përmes e-prokurimit me datën 02.06.2023 ora 16:18.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

OSHP sqaron se nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru per ngrohje te objektev te shkollav ne QKMF - AMF dhe njesive tjera vartese te A.K” me numër të prokurimit 634-22-8230-1-1-1, AK kishte publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me 16.05.2023. Ankuesi kundër këtij vendimi kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim me 20.05.2023 kurse AK me 23.05.2023 e kishte refuzuar kërkesë për rishqyrtim të Ankuesit si të pabazuar.

OSHP konstaton se bazuar në vendimit e cituar si më sipër, afati ligjor për të parashtruar ankesë për OE kishte filluar të rrjedhi që nga data 24.05.2023 deri me datën 02.06.2023 ora 16:00 (*afat ligjor*). Kurse Ankuesi N.T.SH " BEDI COM " kishte parashtruar ankesë me 02.06.2023 ora 16:18 (*ditën e premte-para pas përfundimit të orarit të punës*). Zyrtarja për pranimin e ankesave sqaron se të njejtën e kishte pranuar me 05.06.2023 (ditën e hëne) me numër protokolli 337/2023.

Lidhur me këtë OSHP, sqaron se ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 2 të nenit 109 të LPP-së sipas së cilit parashihet se “.. *Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji...*” lidhur me neni 64.1 të Rregullores Nr. 001/2022, të parashtror ankesë në OSHP, brenda afateve ligjore që rrjedhimisht i bie brenda orarit të rregullt të punës së datën 02.06.202, duke vepruar kështu edhe në përputhje me nenin 5 të LPP-sipas së cilit po ashtu përcaktohet se “*afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.*”

Andaj, mbi bazën e të lartëcekurave OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues tëProkurimit me 05.06.2023 nga OE "BEDI COM" lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru per ngrohje te objektev te shkollav ne QKMF - AMF dhe njesive tjera vartese te A.K”, hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP në përputhje me dispozitat e nenit 109 lidhur me nenin 5 të LPP, lidhur me nenin 64 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik.

Lidhur me kthimin e tarifës ankimore u vendos në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së kurse obligohet Ankuesi që konform nenit 31 pika 6 të së njejtës Rregullore, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh ta bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të

ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - N.T.SH. " BEDI COM "**
- Arkivës së OSHP-së: